



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### Procesverbal i mbajtur më 26 shtator 2023, në mbledhjen e XIV-të (pesëmbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA dhe z.Pajtim Balaj, Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

### Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, me materialet besoj që jeni pajisur të gjithë me kohë ku për këtë mbledhje janë paraparë 9 pika në rend të ditës, para se të hedhim në votim, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me rendin e ditës janë disa propozime që i propozoi për mbledhjen e radhës, fillimisht bëhet fjalë për Marrëveshjen midis Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e Qendrës rezidenciale për qëndrim ditor të personave të moshuar. E dimë që si Kuvend Komunal e kemi marr një vendim lidhur me këtë Marrëveshje, mirëpo edhe pse e kemi pasur një pëlqim paraprak nga MAPL, për disa arsye është kthyer ky vendim dhe normalisht në bazë të procedurës duhet Kuvendi Komunal të merr vendim sërish, kështu që nuk kemi pasur mundësi me përcjell në afatin e rregull kohor për arsye të disa konsultime që është dashur t'i bëjmë me donatorin, dhe pas këtyre konsultimeve e paraqesim këtë propozim vendimin në mënyrë që të kalojë në Kuvend Komunal dhe të votohet si vendim i ri.

Gjithashtu së fundi Komuna e Podujevës e ka lidhur një kontratë për furnizim me mëshqerra në vlerë totale 350,000.00 euro ku tash me vendimin e ri të Ministrisë së Financave çdo participim i qytetarëve dhe në këtë rast fermerëve që participojnë për projektin furnizim me mëshqerra duhet të merret vendimi në Kuvendin Komunal për këtë shumë shtesë buxhetore që është 30% për shumën e participimit të fermerëve, andaj për këtë arsye të limiteve kohore nuk kemi pasur mundësi të përcjellim as këtë propozim me thirrjen e kësaj mbledhje.

Po ashtu kemi edhe një propozim tjetër nga ana Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e që në mungesë të drejtorit për disa arsye, e paraqes si propozim shtesë Raport përfundimtar të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, raport të cilin komisioni që është ngritur nga

ana e Kryetarit të Komunës e ka përfunduar punën dhe i kanë trajtuar të gjitha kërkesat që janë paraqitur për kompensim të dëmit, andaj Raporti nuk ka pasë mundësi të jetë i gatshëm brenda afatit që është dashur të përcjellët si material për seancën e Kuvendit, kështu që edhe këtë propozim e paraqesim si propozim shtesë që ka të bëjë me miratim dhe dërgimin e tij pastaj në Ministrinë përkatëse për kompensimin eventual të dëmeve të shkaktuara, prandaj propozoj që të inkuadrohet në këtë seancë sepse në rast se e lëm për ndonjë seancë tjetër mund të jemi me vonesë sa i përket afateve kohore.

Pra këto janë propozime të reja, si dhe kemi një rast ku është bërë një lëshim teknik nga ana e zyrtarit/es përkatëse rreth propozim vendimit për vënie në diskutim publik të strategjisë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2023-2026, pra me material është bërë një lëshim ku është përcjellë strategjia kombëtare....., ndërsa duhet të jetë strategjia lokale....., kështu që kjo është vetëm plotësim i materialit sa i përket kësaj pike sepse materiali është përcjellë gabim dhe zëvendësohet me këtë material që do t'jua shpërndajmë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, dëgjova që drejtori propozoi dy pika shtesë jo çështje procedurale nga ajo që dëgjova nga drejtori, shembull e përmendi Raportin e komisionit për vlerësimin e dëmit, Komuna jon nuk ka pasur shpallje publike për dëme që ata të aplikojnë dhe ti pasqyrojnë dëmet. Nga lista e paraqitur nuk e shoh që përket me realitetin e asaj që ka ndodhë, pra me këtë nguti nuk e di se si ta quaj, por në rend të parë nëse ka dëme dhe ne kemi potencuar që ka pasur dëme madje unë i kam marr shembull disa shtëpia që kanë qenë të mbushura me ujë, dhe një prej atyre nuk e shoh këtu në listë por përse nuk është ai person apo rast është sepse nuk ka pasur shpallje publike nga Komuna për të aplikuar gjegjësisht për incizimin e situatës për aplikim për dëmet që janë bërë dhe si ka ndodhur ndoshta ish dashtë një sqarim më i thellë pse ka ndodhur kështu. Nuk po e kundërshtoj pse i kanë vlerësuar dëmet sepse është mirë që çdo dëm që është bërë dikujt t'i kompensohet, mirëpo këtu nuk i shoh që janë të pasqyruara të gjitha ato dëme që janë bërë, prandaj mendoj se është në kundërshtim me atë që për të bërë vlerësime për diçka duhet fillimisht të kemi shpallje publike për personat / familjet që kanë pësuar dëme.

Tek pika tjetër që e propozoi drejtori parafolës rreth participimit të qytetarëve, Grupi i LDK-së në vazhdimësi e ka shfaqë mendimin që duke pasur parasysh situatën socio ekonomike në nivel Kosove dhe në veçanti në Komunën ton, dhe duke pasur parasysh që ka mjete buxhetore fundja edhe nëse nuk ka të reduktohet numri i përfituesve e që edhe po e vërejmë në bazë të asaj që aplikuesit për subvencione në bujqësi. Nuk dëshiroj të jem zë kritik por e dini se çka është duke ndodhur brenda familjes, herë burri, here gruaja, dhe është mirë që për participim të shqyrtohet mundësia të hiqet krejt.

Nëse është synim zhvillimi gjegjësisht avancimin e çështjes ekonomike të një familje, të keni parasysh që participimi është mirë të hiqet, nëse nuk ka mundësi tjetër buxhetore të reduktohet numri i përfituesve, por veçanërisht nëse ka synim zhvillimin dhe mirëqenien qytetare në rend të parë është i nevojshëm një komision i cili duhet ta vlerësojë gjendjen se çka është duke ndodh me ato subvencione që qytetarët po i marrin, sepse e kam cekur edhe më parë dhe po e ritheksoj dhe tani që në këtë participim tamam ata që kanë nevojë më së shumti nuk kanë mundësi të përfitojnë për shkak të participimit dhe për këtë po ndërlihem me rastin e fundit kur për përfitim të një mëshqerre një bujk duhet të pariticipoj me mbi 800 euro dhe kjo është një shumë që e ngarkon buxhetin e asaj familje gjegjësisht e asaj ekonomie familjare.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me çështjen e vlerësimit të dëmeve, çdo qytetarë i cili ka paraqitë kërkesë për vlerësimin e dëmeve dhe komisioni kur ka dalë në teren në rast se i ka vërejtur dëmet aty ku i kanë bërë vizitat kanë vlerësuar të gjitha dëmet që janë paraqitur. Siç keni parë në materiale, është një komision prej 5 anëtarëve i përbërë prej shërbyesve civil dhe i cili ka bërë të gjitha ato vlerësime, dhe normalisht që është punë e këtij komisioni për vlerësimet të cilat i ka bërë por edhe për lëshimet eventuale të cilat mund të jenë e që mund të jenë pjesë e jenë pjesë e një vlerësimi tjetër, mirëpo ju kërkoj që ta mbështetni edhe këtë pikë që të futet pikë shtesë dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës që tani më veç është thirr në mënyrë që të mos kemi ndonjë vonesë në

dërgimin e raportit dhe materialeve përkatëse në Ministrinë përkatëse sepse pastaj mund të dalin probleme me kompensimin e dëmeve nëse veç do të ndodh një gjë e tillë nga Ministria, pra këtu është çështja.

Lidhur me çështjen e participimit për furnizimin me mëshqerra, kemi thirrje publike dhe kemi listën fituese të mëshqerrave por që në fazën që jemi tani nuk mund të bëjmë asnjë reduktim të shumës së participimit të fermerëve për arsye se në rast se thirrja publike është me kritere dhe kushte të caktuara atëherë në fund të procesit nuk mundem të ndryshojmë ato kritere. Në të kaluarën nuk ka qenë praktike kjo që participimi të votohet në Kuvend mirëpo me vendim të Ministrisë çdo shtim i fondeve në një projekt të caktuar duhet të kaloj përmes Kuvendi komunal, andaj kërkoj mbështetje në këtë çështje në mënyrë që ky projekt për furnizim me mëshqerra për fermerë të përfundojë sepse pa një vendim të tillë rrjedhimisht i bie që procesi të kthehet në fillim apo ta them të dështoj ky projekt, andaj e përsërisë në mënyrë që të realizohet ky projekt në të mirën e bujqve Llapjan, kërkoj që të votohet ky propozim.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk dua të keqkuptohem kinse ne jemi bllokues apo nuk e mbështesim këtë vendim çfarë do çoftë ai për qytetarët e Komunës ton. Më duket se pati keqkuptim, jam në dijeni se ka pasë thirrje publike për ndarjen e subvencioneve në bujqësi dhe nuk e kontestoj askush këtë, mirëpo nuk ka pasë thirrje publike për kompensimin e dëmeve që janë bërë nga vërshimet, dhe e dini që është hera e dytë që bëhen, madje për të parën është bërë një vlerësim dhe ka mbete aty në pikën zero, ndërsa tani në këtë që kemi sot paravetës po e shoh tani që nuk ka pasur thirrje publike dhe sërish jam ai që nuk do të votoj kundër, do të votoj pro, mirëpo mendoni mirë që nëse nuk ka thirrje publike një pjesë dërmuese e të dëmtuarve potencialisht në shkallën më të lartë se këta që po i shoh në listë, nuk janë në përfshirë këtu, sepse nuk ka pasur thirrje publike. E di që edhe kjo do të mbetet në sirtar sikurse ajo e para, mirëpo ne do ta mbështesim këtë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, sa jam i informuar ka pasur një njoftim publik për qytetarët që ti paraqesin dëmet, them të drejtën unë nuk e kam njoftimin këtu sepse realisht drejtori tjetër merret me atë, mirëpo përgjithësisht qytetarët janë të informuar sepse kjo është bërë si praktikë për mënyrën e vlerësimit të dëmit, sigurisht që mund të ketë ndonjë qytetarë që nuk është paraqitur mirëpo mund të përmirësohet në raportin e ardhshëm.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sqarimi apo opinioni që u tha se qytetarët e kanë ditur, e them se qytetarët i din shumë gjëra por nuk janë ata që mund të bëjnë derisa nuk ka një vendim gjegjësisht një hapje të mundësisë së aplikimit, pra qytetarët shumë gjëra i dinë ashtu siç i dimë edhe ne, por nuk e kanë pasur mundësin e aplikimit. Pra nuk e di që ka pas thirrje edhe pse në kohën ku kishim vërshime, në foltore e kam kërkuar që të lejohet, madje e kam marr shembullin një gruaje që nuk ka të bëjë fare me mua, por që e kam parë dhimbjen, prandaj e kam theksuar atëherë e po e theksoi edhe sot se nuk e ka të lehtë kur dikush shkon dhe e gjen shtëpinë të mbushur me ujë deri te gjunjët dhe pastaj nuk e ka mundësin më të vogël që të kompensohet për të mirat materiale që i janë dëmtuar.

Unë nuk po e shoh një gjë të tillë, mirëpo nuk dua të kuptohem që unë jam kundër, thjesht nuk po më duket mirë për një punë që thuhet se është kryer kur nuk është kryer.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, vërtetë është keq nëse dikush ka pësuar dëme dhe nuk i është dhënë mundësia të aplikoj për kompensimin e dëmit.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, tani sa më informuan se ka pasur thirrje publike në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës, pra ka qenë thirrja për vlerësimin e dëmit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, a e ke fjalën për vërshimet e 16 qershorit apo për cilën situatë bëhet fjalë që keni bërë shpallje publike, për cilin vërshim është fjala sepse kemi pasë 3 vërshime brenda 3 muajve (dhjetor, janar, qershor) e që për dhjetor nuk është bërë asgjë, të janarit është bërë një vlerësim dhe është marr një vendim në Kuvendin e Komunës dhe sërish nuk është bërë asgjë, pastaj të 16 qershorit pa njoftim publik, prandaj e potencova që kemi 3 faza të ndryshme të vërshimeve.

**z.Haki Rudari**, theksoi, fillimisht është mirë që secili propozim me u votu veç e veç për arsyeje se nuk mund të gjitha 3 propozimet ose 3 pika të rendit të ditës me një votim sepse ato nuk votohen blanko, por secili propozim të votohet dhe te kalohet deri te i fundit. Në një listë që neve na ka ardhur për kompensimin nga fatkeqësitë natyrore këtu po theksohet gjatë periudhës qershor-gusht 2023, dhe janë shqyrtuar gjithsejtë 279 kërkesa, tani natyrisht ishte kohë e shkurtë që të shfletojmë të tërën, por aq sa pata kohë ta shikoj në përgjithësi për shumën e paraqitur përgjegjësini e bartë komisioni përkatës, dhe këtë e kam thënë edhe më parë që komplet përgjegjësini e individëve dhe qytetarëve e bartin këta pesë persona që janë anëtarë të komisionit për arsye se këta sigurisht kanë dalë në teren, andaj është apo nuk është reale shuma financiare e vlerësuar, përgjegjësini e bartin komisioni.

Pra të votohen veç e veç pikat e propozuara.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, pajtoj plotësisht që çdo pikë e rendit e cila propozohet si shtesë të votohet veçantë. Gjithashtu kërkoj edhe një sqarim shtesë lidhur me Marrëveshjen me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, ku ne si Kuvend për këtë çështje kemi marrë një vendim, mirëpo shtroj pyetje a është kthyer nga Ministria si paligjshme ai vendim, pra a duhet që ta shfuqizojmë sot atë vendim apo ta nxjerrim një vendim të ri.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, sqarim parafolësit, theksoi, bëhet fjalë për vendim të ri e që normalisht nënkupton edhe shfuqizimin e vendimit të kaluar lidhur me hapjen e rrugës për Marrëveshje në mes Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” për një projekt shumë të rëndësishëm në vlerë totale prej 2,500,000.00 euro ku 2,000.000.00 euro do të kontribuoj Shoqata ndërsa 530,000.00 euro Komuna e Podujevës.

Pra ky propozim vendim që e paraqitëm i hap rrugë lidhjes së Marrëveshjes, përndryshe nuk mund të lidhet një Marrëveshje e tillë.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, sa i përket praktikave të mëhershme ne e dimë që ka raste ku keni marrë vendime pa e pyetur Kuvendin ose kanë qenë të paligjshme ato, prandaj nuk e di përse ndodh kjo ngase sa herë ju kemi bërë thirrje që të shqyrtoni mirë vendimet para se t’i sjellni në Kuvend ngase ka shumë raste që pastaj po kthehen si të paligjshme nga Ministria.

Pra na tregoni bazën ligjore ku është shkel ligji kur e kemi nxjerrë vendimin në fjalë, çka nëse e përsëritim sërish atë shkelje, po dalim edhe jo serioz.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, ndoshta do të ishte mirë të kalojmë në votim mirëpo meqë po kërkohet sqarim shtesë ju them që bashkë me zyrën ligjore e kemi pasur një konsultim paraprak me MAPL për atë vendim të cilin e ka marrë Kuvendi Komunal kemi qenë në komunikim direkt me drejtorin e departamentit ligjor të MAPL i cili e konfirmon që vendimi është në përputhshmëri me ligjin, pastaj në momentin kur kemi marr vendimin si Kuvend i Komunës përveç drejtorit të cekur duhet ta nënshkruajnë edhe zyrtarët e tjerë përkatës, një zyrtarë këmbëngul që për këtë arsye duhet të rikthehet në rishqyrtim dhe pastaj normalisht ata në Ministri i nënshtrohen atij vlerësimi të X zyrtarit dhe neve na kthehet në këtë pikë. E përsërisë që së bashku me zyrtarët e zyrës ligjore kemi qenë në takim me MAPL-së edhe kemi marr konsultim paraprak ligjor që kemi të drejtën dhe është praktikë e mirë konsultimi paraprak, tani edhe për këtë propozim vendim kemi konsultim paraprak ligjor me MAPL-në dhe sipas tyre është në rregull, andaj shpresojmë se meqë tashmë kemi një konsultim më të gjerë me MAPL-në nuk do të kemi probleme.

Është fjala për një projekt tepër të rëndësishëm qoftë për nga funksioni i tij, qoftë nga vlera financiare.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë i hedh në votim veç e veç tri pikat e propozuara për përfshirje në rend të ditës për këtë mbledhje dhe rekomandimin e tyre për shqyrtim në seancën e Kuvendit që është thirr për nesër.

Pra fillimisht e hedh në votim pikën e parë, propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës, çështje për të cilën jemi në dijeni se njëherë është marrë një vendim i tillë por që na është kthyer për disa përmirësime të cilat i sqaroj drejtori i DBF.

Pastaj sipas radhës votojmë për propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “furnizim me mëshqerra”

Dhe për përfshirjen në rend të ditës edhe shqyrtimin e Raportit përfundimtar të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje si pikë shtesë sipas materialit përkatës të paraqitur, dhe atë:*

- **Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr.020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).**

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarë/e të Komitetit, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje si pikë shtesë sipas materialit përkatës të paraqitur, dhe atë:*

- **Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “ Furnizim me mëshqerra “**

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje si pikë shtesë sipas materialit përkatës të paraqitur, dhe atë:*

- **Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës**

**Kryesues i Komitetit**, theksoi, kemi edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me një gabim teknik që është propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë Kombëtare, në fakt ne nuk jemi për çështje Kombëtare, për çështje lokale po, pra këtu është gabimi ku edhe materiali është shkuar gabim dhe tani ju përcjellët materiali i ri që duhet të zëvendësohet me atë të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi që propozim vendimi - materiali nga pika e 9 e rendit të ditës të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, sipas materialit përkatës të paraqitur në këtë mbledhje.*

- **Propozim vendimi - materiali nga pika e 9 e rendit të ditës për shkak të një gabimi teknik të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026 & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026**

**Kryesues i Komitetit**, theksoi, gjithashtu kemi edhe një çështje tjetër e cila duhet të hyjë pikë shtesë e rendit të ditës në këtë mbledhje, pra ka të bëjë me plotësim ndryshimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete, përkatësisht zëvendësimin e një anëtareje nga radhët e komunitetit jo shumicë ashkali e cila ka dhënë dorëheqje për arsye se ka shkuar jashtë vendit, fjala është për ish anëtarën znj.Naile Ahmeti. Pra ne i kemi zhvilluar procedurat, kemi publikuar ftesën për sjelljen e nominimeve dhe kemi një nominim që është znj.Fikmete Qurkollli, andaj nëse nuk dëshiron fjalën ndokush e hedh në votim që edhe kjo pikë të hyjë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri mbështet kërkesa e Kryesuesit të Komitetit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe:*

- **Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkolli.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth rendit të ditës, e hedh në tërësi rendin e propozuar të ditës, përfshirë edhe pikat shtesë të mbështetura paraprakisht.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, miratohet në tërësi rendi i propozuar i ditës, përfshirë edhe pikat shtesë të miratuara paraprakisht në këtë mbledhje si dhe ndryshim- plotësimin e materialit nga pika 9 e rendit të ditës, si në vijim:*

*Rendi i ditës:*

- 1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28.07.2023**
- 2. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026**
- 3. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri**
- 4. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024**
- 5. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF Raporti nga diskutimi publik**
- 6. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027& Raporti nga diskutimi publik**
- 7. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024**
- 8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal- POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL**
- 9. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026**
- 10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).**
- 11. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri Për projektin“ Furnizim me mëshqerra “**
- 12. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës**
- 13. Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkolli.**

## **1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28.07.2023**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, pa plotësim ndryshime apo korrigjime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28.07.2023, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

## **2. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, lidhur me propozim vendimin për miratimin e buxhetit 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026, në bazë të procedurave muaji shtator është muaji i fundit që duhet të votohet buxheti, materiali iu ka ardhur me kohë lidhur me buxhetin për vitin 2024 dhe propozoj që të kaloj për shqyrtim dhe për miratim në seancën e radhës së Kuvendit Komunal.

**z.Haki Rudari**, theksoi, Grupi i LVV normalisht që e përkrah këtë propozim buxhet të miratohet në seancën e nesërme. Kemi një buxhet prej 31,043,019.00 euro, realisht është një buxhet ku secili sektor ka investime që janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj ne e votojmë dhe i rekomandojmë Kuvendit për seancën e thirrur për nesër.

**z.Naim Çunkau**, theksoi, Grupi i LDK-së e mbështet propozim vendimin që të shkoj në Kuvend, mirëpo sa është një buxhet i qëlluar apo sa është një buxhet me projekte zhvillimore në Komunë, dhe sa kanë qenë pjesëmarrës qytetarët si taksapagues të cilat menaxhohen nga Komuna, do ti diskutojmë nesër në Kuvend, por edhe kësaj radhe po na vie një buxhet i papërgatitur, me shkelje ligjore duke filluar nga Ligji mbi Financat. Unë e di që parimisht nuk mund të jesh kundër buxhetit, pra është diçka që duhet të kaloj këtu për në Kuvend Komunal, mirëpo duhet të përfundojnë këto praktika ku qytetarët mos ta kenë zërin e vetë në taksën e tyre që menaxhohet nga Komuna, dhe duhet të lirohemi nga praktika që në qytetin e Podujevës mund të bëjnë çka të duan një grup njerëzish pa i pyetur fare qytetarët. Grupi i njerëzve është në qeverisje katër vite, ndërsa qytetarëve i'u mbeten ato projekte kapitale për më shumë kohë dhe askush më shumë se qytetarët nuk i dinë nevojat e tyre. Sidoqoftë ne e përkrahim që të kaloj për nesër në seancën e Kuvendit.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, ne Grupi i PKD-së e përkrahim që projektbuxheti të kalojë në seancën e radhës, vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim gjatë seancës së Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

## **3. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, Komuna e Podujevës e ka nënshkruar një Marrëveshje në bashkëfinancim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, për furnizim të fermerëve me mekanizëm bujqësor, ku pjesë e këtij projekti kanë qenë edhe fermerët me participimin e tyre deri në 15% të vlerës dhe ky participim apo mjetet buxhetore të fermerëve duhet të kalojnë në Kuvendin Komunal në mënyrë që të shtohet buxheti për këtë projekt.

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, ne Grupi i LVV e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, nga 9 anëtarët e Komitetit, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

#### **4. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në bazë të ligjit për tatim në pronë Kuvendi Komunal e ka për obligim që brenda këtij ligji t'i caktojë normat tatimore për kategoritë e pronave në mënyrë që në bazë të vendimit për vitin 2024 pronat në Komunën e Podujevës do të tatimohen në bazë të përqindjeve të cilat do të caktohen nga Kuvendi Komunal.

Pra duke u bazuar në ligj, edhe në këtë vit normat tatimore janë përbrenda limitit të cilat i përcakton ligji dhe përcaktohen për të gjitha kategoritë që mund të jenë të ndryshme ndërsa nga viti 2025 norma tatimore do të caktohet në bazë vlerës së pronës dhe jo në bazë të kategorisë së pronës, andaj propozim vendimin keni marr me kohë dhe propozoj që të kaloj për diskutim dhe miratim në seancë të Kuvendit Komunal.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, një pyetje për drejtorin, limitet ligjore janë prezantuar si shkallë e tatimit në përqindje, sipas ligjit të ri cila është shkalla më e ulët e tatimit në pronë për pronën rezidenciale, Unë e kam parë në propozim që kemi 0.15% por cila është mundësia e lëvizjes, sa është baza dhe sa është maksimumi.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, ligji i përcakton limitet e tatimit në pronë nga 0.1 % deri 1 %, edhe në këtë vit tatimi bëhet në bazë të kategorive të pronës, varësisht a është tokë bujqësore, objekt industrial, objekt rezidencial, tokë ndërtimore, pra varet kjo, ndërsa nga viti i ardhshëm largohen këto kategori dhe nga viti 2025 edhe tatimi bëhet në bazë të vlerës së pronës e cili normalisht është vlerësim nga ana e Ministrisë së Financave.

Diçka tjetër që është pjesë e ligjit por që normalisht nuk është pjesë e vendimit të propozuar, ka të bëjë me tatimin progresiv që është edhe nga cila fillon llogaritje e tatimit, deri tani llogaritja e tatimit ka qenë shembull, te pronat rezidenciale nga 15,000.00 euro e sipër dhe në qoftë se një pronë vlera e saj ka qenë 30,000.00 euro, ku 15,000.00 euro e para nuk janë tatimuar ndërsa janë tatimuar vetëm 15,000.00 eurot tjerat ku ka qenë limiti 0.15%, ndërsa tani pragu i llogaritjes së tatimit në pronë fillon nga 30,000.00 euro, në qoftë se një pronë në qytet apo fshat e ka vlerën 30,000.00 euro ajo nuk tatimohet fare, ndërsa nëse prona e ka vlerën 40,000.00 euro, do ta tatimohet vetëm 10,000.00 euro, duke i pasur parasysh këto dy çështje ne jemi që për vitin 2024 për pronat rezidenciale të ketë ulje të tatimit, pra qytetarët do të kenë fatura më të lira të tatimit në pronë, përkundrazi që nuk është në limitet minimale norma e propozuar.

Në qoftë se vlerësimi në zonat e fshatrave e që vlerësimi për metër katror të pronës rezidenciale 250 euro metri m<sup>2</sup> nënkupton që nëse ka një shtëpi 130 m<sup>2</sup>, po thuajse se nuk paguan fare tatim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, ne Grupi i PDK-së nesër do të marrim vendim për normën e tatimit për vitin 2024 kështu që unë po e shoh në pikën 1.4 për njësitë rezidenciale të parcelave është 0.10%, kurse për njësitë bujqësore është 0.15 %, këto të tria 1.1 , 1.2 dhe 1.3 i nderuar drejtor nëse ka mundësi nuk do të ishte keq që të jenë 0.10%, tri të parat sidomos. Nuk e di sa është diferenca dhe sa ndikon në të hyrat e tatimit në pronë, nëse ka mundësi do të ishte mirë sepse gjithë e dimë që në vitin 2023 kanë paguar tatim jashtë mase dhe ka qenë tatimi shumë i lartë për të gjithë qytetarët, andaj do të ishte një ndihmesë shumë e madhe nëse jepet mundësia.



**z.Naim Çunaku**, theksoi, me qëllim bëra pyetjen drejtorit të DBF-së sepse e di që kemi pasur ndryshim të ligjit mbi tatimin në pronë, dhe çka është e vërteta nuk kisha informatë të sakt sepse nuk e kam konsultuar atë ligj dhe nuk e di, prandaj i'u drejtova me pyetje dhe më interesojë sa është limiti i fundi i bazës tatimore, mu shpjegua nga drejtori i DBF, mirëpo dua të lidhem me atë se a kemi mundësi e që më parë nuk na është lejuar dhe nuk kemi pasur mundësi të propozojmë lehtësime për qytetarin, dhe nga ajo që e kuptova prej drejtorit i cili e tha që në bazë të përqindjes fillojmë me 0.1% dhe tutje, nëse kemi mundësin të jemi ata që përcaktojmë prej 0.1% e tutje unë atë që e tha z.Bashkim Sylja e mbështes madje edhe nën 0.10% dhe atë nëse ka mundësi sidomos të paktën te pronat bujqësore duke ditë efektet dhe potencialin e angazhimeve në Komunën tonë që një prej ekonomive që mund të zhvillohet është bujqësia, andaj nuk do të donim që qysh në start t'i rëndojmë qytetarët.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, ne Grupi i LVV e përkrahim dhe e rekomandojmë për Kuvend nesër, kështu që vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet tona i japim nesër në kuvend.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

## **5. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF - Raporti nga diskutimi publik**

**z.Pajtim Balaj**, drejtor i DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në mungesë të drejtoreshës së DSHMS znj.Adelina Stublla e cila gjendet në udhëtim zyrtar, propozoi para jush që të përcjellët në Kuvend Komunal nesër për diskutim dhe votim Statuti i QKMF-së në Podujevë i cili i ka kaluar filtrat e Kuvendit Komunal, ka dalë në dëgjim publik, ku dëgjimi publik ka përfunduar me 15 gusht, pra është organizuar debati por nuk ka të dhëna sa persona kanë marr pjesë, si do që të jetë materialet i keni marr me kohë, kështu që mund të vazhdojmë me diskutime nesër.

Unë personalisht nuk kam shumë informacione në detaje se çka përmban ky draft Statut, por meqë është votuar më herët prej Kuvendit komunal për të dalë në dëgjim publik, besojë ju jeni më të informuar, prandaj kërkojë që të votohet ky propozim dhe t'i dërgohet Kuvendit për diskutim dhe votim.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, nisur nga fakti që para një kohe kemi vendos këtu në KPF ku kemi theksuar se asnjë pikë që nuk prezantohet nga drejtori apo drejtoresha përkatëse, të mos e kalojmë për në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, edhe pse procedurat janë ashtu siç e përmendi drejtori z.Pajtim Balaj, ky draft fillestar i Statutit të QKMF-së ka kaluar fazat dhe tani e kemi si draft final ku kemi mundësi ta ndryshojmë. Do të doja të parashtroj disa pyetje por duke pasë parasysh që drejtoresha e DSHMS nuk është prezentë në sallë, atë pyetje e orientoj për Kryesuesin e Kuvendit, por nëse mendon se nuk ka përgjigje në rregull mund të mos përgjigjet e mirëkuptoj.

Nga ajo pash kemi një statut të një organi, cili do qoftë ai, në rend të parë nuk ishte e shfaqur sa Qendra të Mjekësisë Familjare ka, pastaj si mund të bëhet një Statut kur nuk e din sa anëtarë ka.

Forma e përzgjedhjes dhe si menaxhohet, për sektorin e punëtorëve shëndetësor është në rregull sepse nuk i kuptoj shumë ato çështje, mirëpo te këshilli i pacienteve që ishte një pjesë e vendimmarrjes brenda QKMF-së është përcaktuar që është, mirëpo nuk ishte si si zgjedhet, sa është mandati, procedurat e zgjedhjes dhe kompetencat e tij dhe si përfundon mandati, këto çështje në Statut është dashtë të jenë të

sqaruara. Sërish i drejtohem Kryesuesit të Kuvendit për një diçka që më bëri përshtypje sikur të ishte hartues i këtij Statuti të Kryesues sepse në fund po shkruan Hilmi Hoxha-Kryesues i Kuvendit, që faktikisht ashtu është, nuk e di a e keni parë këtë, Hilmi Hoxha është Kryesues për vendimmarrje në Kuvend dhe i nënshkruan vendimet e Kuvendit Komunal por nuk është propozues i Statutit, unë e pash ashtu edhe pse në këtë kohë ndoshta u kanë mundësia me qenë një Statut krejt tjetër, me përmbajtje, më i detajuar dhe konciz për ato materie që i rregullon, por vërtetë ky është vetëm sipërfaqësor.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, drejtoresha e DSHMS nuk është prezentë dhe ky dokument ka ardh nga kjo Drejtori dhe nga QKMF, andaj ato probleme që po i cekni ju, më së miri i njeh ajo, kurse sa i përket asaj që është shkruar emri im në fund të dokumentit, nuk e di ndoshta është një gabim teknik.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk kemi propozues të këtij akti, Kryesuesi nënshkruan vendimet e Kuvendit Komunal e jo draft statutin, a duhet një ditë të përparojmë si shoqëri dhe si vendimmarrës në këtë kontest jo diçka tjetër, pra e ke një statut përpara dhe nuk e dimë sa QMF i kemi, në fakt ne e dimë por aty nuk shkruan, nuk e dimë sa anëtarë të këshillit i ka, në këtë kontekst e them sepse si dokument i komunës të jetë më i pasur ngase është edhe dokument i imi fundja.

**z.Pajtim Balaj**, drejtor i DKRS, theksoi, nuk mund të lëshohem në përmbajtje sepse nuk e njoh as vetë ndoshta është ashtu siç e potencoj z.Naim Çunaku, mirëpo nëse ka qenë një dëgjim publik dhe e keni pasur mundësin të gjithë t'i jepni sugjerimet e juaja se ku është e nevojshëm të ndryshohet korrigjohet, mendoj që është jo korrektë që nuk e keni bërë. Secili qytetarë mund të marr pjesë në diskutim publik për të dhënë sugjerimet e veta, nuk jemi të gjithë të dijshëm, normal që një Drejtori mund të mos ketë një jurist të mirë por sërish mendoj që është e rrugës me dhënë kontributin të gjithë sepse po bëhet fjalë për shëndetin tonë, dhe gjithë qytetarët duhet të japin mendimet e veta.

Nëse DSHMS nuk i merr për bazë pastaj ju jepet mundësi t'i thoni që ne të kemi asistuar por ke vazhduar me modelin e keq. Nëse rast se duhet të përmenden shtëpitë e shëndetit, në rast se duhet të përmenden dhe në rastin tjetër ne çdo vit e ndërtojmë nga një qendër, a duhet ne pastaj çdo vit të bëjmë nga një Statut të ri. Mendoj që draft Statuti i përcakton rregullat e funksionimit dhe nuk është dokument statistikor.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, as më të voglin qëllim nuk e pata që të hyjë në polemik me drejtorin e DKRS-së dhe të gjejë fajtorin, por drejtori i cekur që nuk është në gjendje të sqaroj për këtë Statut mirëpo din politikisht të tregoj procedura, vërtetë është për keqardhje drejtor, dhe nëse ti mundohesh të fajësosh një anëtarë të KPF-së në këtë rast, duke i thënë pse nuk ke marr pjesë në fazën e ndryshimit, unë atë fazë e kam edhe sot edhe nesër, dhe nëse ti mendon që Kuvendin Komunal ta trajtosh si një qytetar nuk je në rregull. Edhe njëherë e them se krejt me qëllimin me të mirë theksova si që si dokument i Komunës dhe se është publik, të jetë përmbajtësorë dhe më i pasur, ndërsa ky (i drejtohet drejtorit të DKRS) që po mundohet të gjuaj kinse e zura dikë për diçka, i them se mund të bëhet Statuti i QKMF pa vendim të Kuvendit të Komunës. Në këtë Statut shkruan se nuk mund të ketë QKMF kur nuk e frekuentojnë 2000 banor, pastaj sa qendra të mjekësisë familjare i kemi për 200-300 banor, por nuk desha të hyj në atë, prandaj i nderuar drejtor i DKRS, nuk e pate të drejtën të më fajësoni mua.

**z.Pajtim Balaj**, drejtor i DKRS, theksoi, sa i përket pjesës së fajit, nuk është qëllimi të faji sepse ne këtu jemi duke diskutuar, nuk e bëra fajtor askënd unë, ishte sugjerim i imi se çfarë ke mund të bësh prej pozicioni tënd, prandaj nuk bëhet fjalë për faj këtu, dhe tentoni që mos kaloj kjo në personale kjo çështje sepse ti (i drejtohet z.Naim Çunakut) po merresh me mu, kurse unë po merrem me përmbajtjen e asaj që e the, kjo është problem i madh.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, anëtarët e KPF-së kanë mundësi sot të japin propozime për ndryshime sikurse që kanë edhe nesër anëtarët e Kuvendit, kështu që i nderuar drejtor i DKRS-së përgjegjësini që pse qytetarët nuk kanë debatuar dhe pse nuk kanë marr pjesë në procedurë të ndryshimit dhe hartimit të këtij Statuti që është mirë të jetë më i kompletuar e që do të dilte edhe më mirë edhe Komuna.

Sa jam në dijeni unë vetëm një QKMF e kemi, kurse tjerat janë shtëpi shëndetit, në qoftë se vendoset të ndërtohen tjera ne marrim vendim për ta ndërtuar.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk mundet të ndërtohet QKMF pa vendim të Kuvendit Komunal.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, anëtarët e këtij Komiteti, këtu në mbledhje e kanë vendin ku të japin sqarime dhe të debatojmë dhe të ngritin çështjet në mënyrë që dokumenti të dal sa më i kompletuar, kështu që në seancë është vendi ku mund të japim vërejtje dhe sugjerime si anëtar të KPF-së dhe Kuvendit.

**z.Haki Rudari**, theksoi, jam duke e lexuar Statutin e QKMF-së ku neni 2 pika 2 thekson që themeluesi i QKMF-së është Kuvendi Komunal - Podujevë dhe në pikën e 3 thekson që institucioni i parë shëndetësor në Podujevë 30.08.1945 shtëpi e shëndetit, pastaj si QKMF nga viti 2000-2005.

Po është e vërtetë që tha kolegu që në nenin e 11 parashihet të formohet Këshilli Drejtues prej 7 anëtarëve. Unë do të ndalem në dy çështje që u theksuan më herët nga kolegu parafolës zotëri Çunaku, tek pika 1.6 thotë përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote dhe 1.7 thekson, përfaqësues nga këshilli i pacientëve pa të drejtë vote, po është e vërtetë që forma e përzgjedhjes nga Këshilli i pacientëve nuk specifikohet, ndërsa te sindikata po, sepse është në kuadër të sindikatës të QKMF-së.

Sa i përket raportit të konsultimit publik për draft Statutin e QKMF-së, dhe sipas raportit të datës 15.08.2023 kanë marr pjesë në sallën nr.52 gjithsejtë 13 persona dhe nga i cili nuk ka dal asnjë sugjerim.

Pajtohem me koleg që edhe ne KPF edhe nesër në seancë kemi të drejtë t'i japim propozimet dhe mendoj që ato propozime që janë të mira dhe të nevojshme mund t'i bëjnë edhe nesër në seancë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

## **6. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 - Raporti nga diskutimi Publik**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, meqë drejtori i DSHPMSh nuk gjenden këtu për shkak të disa punëve urgjente. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave i ka kaluar të gjitha procedurat dhe është raporti për diskutimin publik, propozoi që të kaloj për diskutim në seancën e Kuvendit.

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë propozim plan komunal për menaxhim të mbeturinave 2023-2027 si dhe raporti i nga diskutimi publik.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje*

## **7. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024**

**z.Avni Fetahu**, drejtor i DKA, e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, para vetës keni një informatë për fillimin e vitit shkollor e kërkuar sipas planit të punës së Kuvendit Komunal, besojë që e kemi bërë një përmbledhje të duhur për fillim vitit shkollorë dhe të gjitha të dhënat i keni të paraqitura në këtë informatë kështu që nuk po e zgjati më shumë, por nëse keni diçka për pyetur këtu jam, sigurisht që edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit do të debatohet për këtë informatë.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024, dhe e rekomandojmë për mbledhjen e Kuvendit nesër.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, Grup i LDK-së e përkrahim këtë informatë të DKA-së të cilën edhe e kemi votuar së bashku me planin e punës së Kuvendit kur ka qenë. Sigurisht që nesër në mbledhjen e Kuvendit do të debatohet dhe do të doja që raporte të tilla të kemi më shpesh, madje edhe raporte të organizatave të punës ku edhe po përfundon viti dhe nuk e kemi ende një raport prej tyre.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për diskutim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

## **8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal- POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, meqë drejtori i DSHPMSH nuk gjendet këtu për shkak të disa punëve urgjente që ka pasë siç e theksova edhe më herët, andaj materialin e keni marrë me kohë dhe propozoj që ky propozim vendim të kaloj për diskutim në mbledhjen e Kuvend Komunal.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë plan operativ emergjent lokal dhe mendojmë që është shumë i rëndësishëm, prandaj edhe do të votojmë që t'i rekomandohet Kuvendit ku sigurisht se do të shkojmë me propozime dhe sugjerime konkrete.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim, është një diçka që kemi kërkuar prej kohës por e vetmja dilemë që tani na paraqitet që nuk është prezent drejtori i DSHPMSH dhe as kryetari i Komunës i cili është edhe kryesues i KKS-së, por që nesër sigurisht se do të jenë për të na dhenë sqarime rreth prioriteteve.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

**9. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë sipas materialit përkatës me ndryshim plotësimet e prezantuara në këtë mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës me ndryshim plotësime të prezantuar në këtë mbledhje.*

**10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.*

**11. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin“ Furnizim me mëshqerra“**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.*

**12. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.*

**12. Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj.Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj.Fikmete Qurkollli.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë sipas materialit përkatës të propozuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit u konstatua se Njëzëri, me 9 vota Për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.*

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:10**

**Procesverbalin e mbajti;  
Sabedin Namani**

**Nr.Prot.01-060/04-0071602/23  
Podujevë,  
26 shtator 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha**